



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Strategjik dhe Operacional i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2022-2025.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ (shtojca 1. e PSO) për vitin 2022 t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/56

Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Zbatimin e Lehtësirave Doganore dhe/ose të Kontrollit të Hyrjes/Daljes së Mallrave.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/56

Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Sigurime Shoqërore në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni Ekzekutiv për zhvillimin e sistemit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional kundrejt nevojave të tregut të punës të Republikës së Kosovës ("Komisioni") me këtë përbërje:
  - 1.1. Z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës, kryesues;
  - 1.2. Znj. Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
  - 1.3. Z. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve;
  - 1.4. Znj. Rozeta Hajdari, Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
  - 1.5. Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë;
  - 1.6. Znj. Majlinda Rizvanolli - Bajraktari, Këshilltare e jashtme për Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP); dhe
  - 1.7. Z. Enis Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
2. Kryesuesi, nga pika 1. e këtij Vendimi, mund të ftojë edhe anëtarë tjerë sipas nevojës, përfshirë anëtarë nga kabineti qeveritar, këshilltarë politikë, shërbyes civilë apo ekspertë.
3. Komisioni mund të themelojë grup më të ngushtë ekspertësh (Task-Forcë) lidhur me segmente të veçanta në lidhje me zhvillimin e sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional. Përbërja e Task-Forcës do parashihet me Vendim të veçantë të Komisionit.
4. Obligohet Komisioni të identifikojë, komunikojë dhe delegojë objektivat përkatëse të planit të projektit për zbatimin e masave të parapara për sistemin e AAP-së brenda strategjisë së përmendur më parë.
5. Obligohet Komisioni që në periudha të rregullta (tre mujore) të kontrollojë ecurinë e punës në lidhje me objektivat përkatëse, të përpilon rekomandime të qarta lidhur me strukturë të qeverisjes për Arsim dhe Aftësim Profesional (AAP) për periudhën pasuese, pas pranimit të raportimit nga Task-Forca.
6. Komisioni ka të drejtë që, në rast të vonesave të zbatimit të masave, të pyet për prioritizimin dhe alokimin e kapaciteteve brenda ministrisë përkatëse.



7. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, të kryejë shërbimet e Sekretarisë së Komisionit, në kuptim të procedurave administrative që përcjellin funksionimin e Komisionit.
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Anëtarëve të Task-Forcës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohen dhe plotësohen pikat 2.70, 2.155 dhe 2.156 të Vendimit të Qeverisë Nr. 02/50 të datës 23.12.2021, si vijon:
  - 1.1. Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e Udhëzimit të ri Administrativ që rregullon këtë çështje;
  - 1.2. Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 02/2017 për Vlefshmërinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Lartë, mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e Udhëzimit të ri Administrativ që rregullon këtë çështje;
  - 1.3. Udhëzimi Administrativ (MASHT) Nr. 08/2019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës mbetet në fuqi deri në nxjerrjen e Udhëzimit të ri Administrativ që rregullon këtë çështje.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh. A. emëron këta kandidatë:
  - 1.1. Z. Fadil Bejta, kryesues;
  - 1.2. Znj. Safije Beseni, anëtare;
  - 1.3. Znj. Hyrmete Mydyti, anëtare;
  - 1.4. Znj. Sebahate Krasniqi, anëtare;
  - 1.5. Z. Visar Nura, anëtar; dhe
  - 1.6. Z. Gëzim Paci, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 46 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, nenit 4 të Rregullores Nr.29/2018 të Punës së Komisionit Kombëtar për Refugjatë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Pasqyra Preliminare Financiare për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Bilancin e Fondeve për vitin 2021.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Pasqyrën Preliminare nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohen ndryshimet në tabelat 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale shumëvjeçare në bazë të paragrafit 2. të nenit 9. të këtij Ligji.
2. Obligohen Ministrinë e ndikuara dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me tabelat nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës për informim.
4. Vendimi hynë në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-030 Për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës - Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, të Ligjit Nr. 08/L-009 për Ratifikimin e Amendamentin Nr. 1. të Marrëveshjes Kornizë së Kredisë së datës 14 gusht 2020, Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021 dhe me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Aprovohet pagesa e shtesës neto prej 10% të pagës bazë, por jo më pak se 60 € (gjashtëdhjetë euro), për punonjësit shëndetësorë të sektorit publik (profesionistët shëndetësor dhe stafin mbështetës), deri në gjashtë muaj, përkatësisht periudhën janar - qershor 2022, në shumë totale deri në 5,600,000 € (pesë milionë e gjashtëqind mijë euro), në zbatim të masës 4.1 - Mbështetja e Shëndetësisë, bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin 00098, në kategorinë "Paga dhe Shtesa" në secilën organizatë buxhetore të ndikuar nga ky Vendim, bazuar në listën finale të ekzekutuar, dhe realizohet jo më vonë se 15 ditë nga ekzekutimi i pagave.
3. Shtesa sipas pikës 1. kalkulohet në baza mujore mbi pagën bazë, sipas afatit në pikën 1, ose deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të Pagave për Sektorin Publik, në bazë të listave emërore që pranohen nga Ministria e Shëndetësisë, për të gjitha organizatat buxhetore që kanë punonjës shëndetësorë, për secilin muaj veç e veç, bazuar në pagën bazë të definuar në Sistemin e Pagave të Thesarit të Kosovës.
4. Listat finale të aprovuara dhe dërguara nga Ministria e Shëndetësisë për realizim nga Thesari i Kosovës sipas pikës 4. të këtij Vendimi, paguhet përmes Sistemit të Pagave, me pagën e muajit përkatës, përkatësisht vijues.



5. Mjetet e shpenzuara sipas këtij Vendimi, janë subjekt i rimbursimit eventual, deri në shumën në dispozicion të mjeteve të lira të pashpenguara nga kredia "Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës", si financim retroaktiv nëpër organizata buxhetore aty ku ka ndodhur shpenzimi, bazuar në Ligjin për ndarjet buxhetore.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Shëndetësisë, dhe Organizatat buxhetore për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 3,000,000.00€ (tre milionë euro) për subvencionimin e policave kufitare, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021 dhe me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021 (këtej e tutje referuar si "Vendimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike") lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Masa 4.5 "Mbështetja e Mërgatës".
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria ekonomike "Subvencione dhe Transfere" dhe transferohen me kodin 00098 te nën-programi "Thesari" me kod 11200, në kategorinë ekonomike "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet e ndara sipas këtij Vendimi do të shfrytëzohen për mbulimin apo rimbursimin e kostos së policave kufitare të bashkatdhetarëve tanë deri më datë 31 dhjetor 2022, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me Vendim të veçantë të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve në bazë të autorizimeve të dhëna sipas Vendimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Thesari për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të Qeverisë Nr. 26/19 të datës 14.07.2021, ndryshohen dhe plotësohen nënpikat 2.3, 2.6 dhe shtohet nënpikat 2.15 dhe 2.16 si dhe pikat 4, 5 dhe 6 sipas këtij Vendimi:
2. Në pikën 2. të Vendimit Nr. 26/19 i datës 14.07.2021 ndryshohen dhe plotësohen nënpikat 2.3, 2.6 si dhe shtohen nënpikat 2.15 dhe 2.16.
  - 2.1. Nënpika 2.3 e Vendimit Nr. 26/19 ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: në vend të z. Mehmet Kraja, emërohet znj. Edi Shukriu-Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës-anëtare;
  - 2.2. Nënpika 2.6 e Vendimit Nr. 26/19 ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Përfaqësuese e Zyrës së Kryeministrit caktohet Rozafa Kelmendi;
  - 2.3. Vendimit Nr. 26/19 i shtohet nënpika 2.15 si në vijim: Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë caktohet Valëza Sadriu;
  - 2.4. Vendimit Nr. 26/19 i shtohet nënpika 2.16 si në vijim: z. Andrew Herscher, Profesor në Universitarin e Michiganit, anëtar.
3. Anëtarët e Komisionit obligohen të punojnë në përputhje me Procedurën e brendshme operative e cila hartohet me qëllim të zbatimit të punës së Komisionit. Kjo rregullore aprovohet nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Me qëllim të lehtësimit të punës së komisionit, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit emëron Sekretariatit e Komisionit.
5. Anëtarët e Komisionit Shtetëror dhe Sekretariati kompensohen për punën e tyre.
6. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të bëjë zbatimin e pikës 5 të këtij Vendimi.



7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Strategjia për Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/56  
Datë: 26.01.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 janar 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Verëtarinë.
2. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë